



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

Nr. 448 Prot.

Tiranë, më datë 01.11.2019

VENDIM

Nr.370, datë 01.11.2019

PËR

MIRATIMIN E PROJEKTIT ZHVILLIMOR

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018, “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 48, pika 1 dhe neni 134, pika 1, pas shqyrtimit më parë në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në mbledhjen e datës 01.11.2019,

VENDOSI:

1. Miratimin e projektit “Rehabilitimi i rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizime Berat”, pjesë e projektit të infrastrukturës bashkiake III, Berat, Kuçovë, Librazhd, me kërkesë të shoqërisë “p2mberlin”, me sugjerimet:
 - Për Qendrën Historike, lagjia “Goricë”, vendosja e matësve të ujit të jetë me kuti metalike dhe të maskuar me gurë natyralë;
 - Pusetat (kutitë) e matësve të ujit të vendosen në kalldrëm dhe maskimi të bëhet me gurë natyralë;
 - Të parashikohet ringritja ose restaurimi i mureve rrethuese të banesave;
 - Restaurimi i kalldrëmit të kthehet në gjendjen e mëparshme sipas teknikës tradicionale të restaurimit duke ruajtur konfigurimin e tyre dhe trajtimin me aks kullimi në mes të tij;
2. Gjatë procesit të zbatimit, siç parashikon dhe legjislacioni për trashëgiminë kulturore, punimet të mbikëqyren sipas Ligjit Nr. 27/2018, datë 17.05.2018, “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, nenet 144-147;
3. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
4. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR I KKR

Arta Dollani

K R Y E T A R

Elva MARGARITI

